



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

### NJOFTIM PËR VENDE TË LIRA PUNE

#### ***Kontrolli i Lartë i Shtetit hap konkursin për vende të lira pune:***

#### **I. Për 2 (dy) vende në pozicionin e Auditesit në Departament Auditimi.**

#### **Kërkesat për kandidatët e këtyre vendeve të punës janë:**

-Të kenë kryer arsimin e lartë dhe të jetë diplomuar jo më poshtë se niveli master Shkencor në Financë/Kontabilitet.

-Të kenë eksperiencë pune në fushën e diplomimit.

-Të zotërojnë gjuhën angleze dhe një gjuhë të dytë të huaj të një prej vendeve të BE-së.

-Të zotërojnë programet bazë të kompjuterit; teknikat CAAT në Auditim si dhe programet e Mbajtjes së Kontabilitetit Alpha/Financa.

-Të kenë aftësi të mira menaxhuese dhe komunikuese për të punuar në grup.

Paga mujore për këtë vend pune është në nivelin e pagave të shërbimit civil.

#### **Përshkrimi i punës**

Kryen në mënyrë ligjore, profesionale, etike dhe brenda afateve të përcaktuara detyrat Audituese. Zbaton programin e auditimit, ndërsa për problemet që nuk janë përfshirë në programin e auditimit, ia bën prezent përgjegjësit të grupit të auditimit. Gjykon për nivelin e materialitetit e të riskut. Gjatë veprimtarisë audituese harton dokumentat e auditimit. Gjithashtu, në bashkëpunim me përgjegjësin e grupit të auditimit harton projektraportet e auditimit, pasqyron me shkrim sqarimet për vërejtjet e bëra nga subjekti i audituar, gjithashtu harton raportet përfundimtare të auditimit dhe projektvendimet përkatëse. Plotëson dhe nënshkruan statistikat e kontrollit, si evidencën e kostos, evidencën e zbulimeve, të masave të propozuara dhe gjithë dokumentacionin e auditimit. Në përgatitjen e materialeve të auditimit zbaton dhe mban përgjegjësi për afatet kohore të parashikuara. Jep mendime për përmirësimin e punës së departamentit e të institucionit, si dhe për ndryshimin e akteve ligjore e nënligjore, të cilët ai i çmon të arsyeshme. Paraqet çdo 3-muaj raportin e aktivitetit të tij përpara drejtorit të departamentit.

#### **Paraqitja e dokumenteve**

Kandidatët duhet të paraqesin në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore deri në datë 28 Dhjetor 2018 këto dokumente: Letër motivimi për aplikimin në vendin vakant, CV-në, kopje të diplomës së shkollës së lartë dhe të kualifikimeve pasuniversitare, kopje e listës së notave dhe librezës së punës të noterizuara, fotokopje e letërnjoftimit, rekomandime nga punëdhënësit e mëparshëm, dëshmi penaliteti, si dhe dokumente të tjera (nëse ka), që i çmon se mund t'i vlejnjë për vlerësimin e përgatitjes arsimore dhe profesionale, si dhe dëshmi të dokumenteve ose jo të zotërimit të gjuhëve të huaja.

#### **Konkurrimi**

Konkurrimi është i hapur për nëpunësit civilë nëpërmjet procedurave të pranimit.

Konkurrimi do të bazohet në njohuritë për Kushtetutën, ligjin nr. 154/2014 datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", ligjin nr. 152/2013, "Për Nëpunësin Civil", i ndryshuar, ligjin nr. 9131, datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike", "Rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH", "Standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t, mbi njohuritë dhe të dhënat që jepen në serinë e botimeve të KLSH-së 2012-2018, si dhe në faqen zyrtare të KLSH-së në internet". Në faqen zyrtare [www.klsh.org.al](http://www.klsh.org.al) sipas afateve të përcaktuara në ligj, më datë 28 Dhjetor 2018 do të shpallet edhe lista e verifikimit paraprak të kandidatëve, si dhe data e zhvillimit të konkurrimit.

**Kontrolli i Lartë i Shtetit**